

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI: “Prodhim i ortofotove nga fotografitë ajrore historike”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): 79961200-0
VLERA E FONDIT LIMIT: 14,243,179 (katërmëdhjetë milion e dyqind e dyzet e tre mijë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a. ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 9 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke vlerësuar që plotësimi i kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 9 të DST provon mjaftueshëm përshtatshmërinë profesionale të ofertuesve.

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A)¹ Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto x

Sipas rëndësisë

¹ Shënim. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehesh në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë. Në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, kriter për shpalljen e ofertës fituese do të jetë “oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto”, ku çmimi do të ketë 20 pikë dhe propozimi teknik 80 pikë.

Kriteri:

- | | |
|------------------------------------|--------------|
| 1. Çmimi | 70 pikë |
| 2. Afati i realizimit të kontratës | [0- 30] pikë |

Argumentimi i kriterëve të pikezuara dhe menyra e llogaritjes së pikeve:

- | | |
|-----------|---------|
| 1. Çmimi: | 70 pikë |
|-----------|---------|

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij

Pikët për këtë kriter përlogariten sipas formulës:

$$Pk1 = V_{mink1} \times P_{maxk1} / Ok1$$

$Pk1$ _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

V_{mink1} _____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

P_{maxk1} _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$Ok1$ _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

- | | |
|------------------------------------|--------------|
| 2. Afati i realizimit të kontratës | [0- 30] pikë |
|------------------------------------|--------------|

Kohëzgjatja totale e realizimit të shërbimit nga ku afati më i shkurtër i paraqitur nga ai i kërkuar në DST merr më shumë pikë

Pikët për këtë kriter përlogariten sipas formulës:

$$Pk1 = V_{mink1} \times P_{maxk1} / Ok1$$

$Pk1$ _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

V_{mink1} _____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

P_{maxk1} _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$Ok1$ _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

Argumentimi: Bazuar në nenin 45 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, është përzgjedhur Oferta ekonomike më e favorshme, bazuar në kosto për shkak të natyrës komplekse të shërbimit dhe është gjykuar në përputhje me parimin e balancimit midis koston dhe cilësisë.

Mbështetur në rëndësinë dhe urgjencën nga ana e Autoritetit Përfutës është gjykuar e arsyeshme që pikëzimi të mbështetet te Çmimi dhe Afati i realizimit të kontratës në plotësim të nevojave të AK duke siguruar një çmim më të mirë dhe duke mos rrezikuar edhe diegjen e fondit të akorduar për këtë kontratë.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 20 % e vlerës së fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2022, 2023, 2024), të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentim: Kriteri vendoset bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitetin financiar për zbatimin e marrëveshjes kuadër.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar kontratën, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të të dëshmojë dhe të paraqesë certifikatë (të vlefshme), si më poshtë:

- SSH EN ISO 9001:2015 (për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë), ose ekuivalente/të barazvlefshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Standarti ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” – Ky standard është i nevojshëm pasi ndikon në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, duke qenë se ky standart fokusohet në cilësinë e projektit të përfutur rrjedhimisht siguron AK që ofertuesi do të përmbushë/realizojë shërbimet objekt prokurimi, sipas pritshmërive/termave të references të kërkuara.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë licencë Profesionale të vlefshme, si më poshtë:

- Licencë – Kategoria-8, pikat d) Bazamente gjeodezike, e) projektim fotogrametrik dhe hartografik.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të kenë licencën profesionale të shoqërisë për realizimin e shërbimit , objekt i kontratës, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore.

Kategoria e kërkuar e licencës është kërkuar bazuar në natyrën e shërbimit të kërkuar dhe detyrat specifike të përcaktuara nga Autoritetit Kontraktor përfitues e cila shërben për të rritur besueshmërinë dhe sigurinë që produkti final do të jetë në përputhje me kërkesat dhe objektin ku përfshihen: krijimi i bazamenteve gjeodezike, orientimi dhe ortorektifikimi i imazheve historike të skanuara.

Projektimi fotogrametrik dhe hartografik kërkon njohuri dhe aftësi të thella teknike për transformimin e fotografive ajrore në produkte të sakta si ortofotot dhe hartat. Licenca siguron që këto punë do të kryhen me saktësi të lartë.

2.3.4 Ofertuesi duhet të përgatisë dhe të dorëzojë një dokument "Ofertë teknike" me kërkesat e listuara si më poshtë:

- Ofertuesi duhet të përgatisë dhe të paraqesë ofertën teknike - një dokument, ku duhet të përshkruajë dhe të dokumentojë se si do të plotësohen kërkesat e detajuara në Termat e Referencës.
- Një përshkrim i detajuar i softeve apo softit që do të përdoret për Aerofototriangulacionin dhe për prodhimin e Ortofotos.
- Ofertuesi duhet të paraqesë një Plan “Produkt i Cilësisë”. Ky plan do të përshkruajë se si ofertuesi garanton përmbushjen e kërkesave teknike të projektit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të paraqesin një ofertë teknike ku do të përfshijë dhe njëplan me ane të cilës operatori garanton kërkesave teknike të projektit.

Oferta teknike tregon se ofertuesi e ka lexuar dhe kuptuar në detaje objektin, kërkesat dhe standardet që kërkohen, Përshkruan qartë mënyrën se si do të realizohen aktivitetet, metodat do të përdoren, duke treguar seriozitet dhe angazhim.

Përshkrimi i softuerëve të përdorur tregon që ofertuesi zotëron mjetet e nevojshme për realizimin e procesit teknik të ortofotografisë si dhe kapacitetin për të përmbushur kërkesat specifike teknike të projektit.

Plani “Produkt i Cilësisë” përshkruan metodat, proceset dhe kontrollet që do të përdoren për të siguruar që produktet (ortofotot) janë në përputhje me standardet dhe kërkesat teknike të përcaktuara. Shërben për parandalimin e gabimeve dhe defekteve, pasi mund të korrigjohen në kohë gabimet dhe defektet si dhe ndihmon në marrjen në dorezim të produktit final.

2.3.5 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për kryerjen e shërbimit objekt prokurimi, duhet të kenë të punësuar minimumi **4 (katër)** punonjës, si më poshtë:

- 1 (një) Ekspert në fushën e projektimit fotogrametrik dhe hartografik
- 1 (një) Ekspert për ndërtimin e bazamenteve gjeodezike
- 1 (një) Ekspert administrim harduere & softuare dhe rrjetesh kompjuterike
- 1 (një) punonjës ndihmës projektuesh

Për punonjësit e kërkuar me lart, duhet të paraqiten dokumentat:

a. Për Ekspert në fushën e projektimit fotogrametrik;

dhe për këtë punonjës duhet të paraqitet:

Diplomë me profil Inxhinier Gjeodezi/ Inxhinier Gjeofizikë/ Inxhinier Gjeomatikë (ose ekuivalente për ekspertë të huaj),

- Kontratë pune (e vlefshme), CV përkatëse;

b. Për Ekspert për ndërtimin e bazamenteve gjeodezike;

dhe për këtë punonjës duhet të paraqitet:

Diplomë me profil Inxhinier Gjeodet/ Inxhinier Gjeomatikë/ Inxhinier Gjeoinformatikë (ose ekuivalente për ekspertë të huaj),

- Kontratë pune (e vlefshme), CV përkatëse;

c. Për Ekspert administrim harduere & softuare dhe rrjetesh kompjuterike;

dhe për këtë punonjës duhet të paraqitet:

Diplomë me profil Teknologji Informacioni/ Informatike (ose ekuivalente për ekspertë të huaj),

- Kontratë pune (e vlefshme), CV përkatëse;

d. Për punonjësin ndihmës projektesh

- Kontratë pune përkatëse, (e vlefshme) , diplomë në shkenca kompjuterike ose ekuivalente

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Deklarata provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion stafin e nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit i cili nga natyra është komplekse dhe kërkon staf të kualifikuar me diplomën përkatëse dhe eksperiencën në këtë fushë.

Eksperti në fushën e projektimit fotogrametrik dhe hartografik është përgjegjës për përpunimin dhe analizën e fotografive ajrore historike për të krijuar ortofotot. Gjithashtu eksperti në fushën e projektimit kupton me se miri softuret fotogrametrike, kupton hartat ekzistuese si dhe percakton metodologjinë e projektimit të rrjetit fotogramatik.

Eksperti për ndërtimin e bazamenteve gjeodezike- Për të siguruar realizimin cilësor dhe me saktësi të shërbimit nevojitet eksperti në punimet gjeodezike për ndërtimin e bazamenteve gjeodezike, të cilat do të shërbejnë për mbajtjen e pikave të kontrollit që përdoren për realizimin e orientimit të fotografive ajrore historike të skanuara në sistemin referues gjeodezik shqiptar.

Eksperti administrim harduere & softuare dhe rrjetesh kompjuterike kujdeset për instalimin dhe mirëmbajtjen e softuerëve fotogrametrikë dhe hartografikë, menaxhon ruajtjen dhe shpërndarjen e të dhënave etj.

Punonjësi ndihmës projektesh ndihmon në koordinimin e detyrave teknike, mbledhjen dhe përpunimin e dokumentacionit teknik, financiar dhe administrativ, asiston në dokumentimin e fazave të ortorektifikimit dhe prodhimit të ortofotove, ndihmon në përgatitjen e materialeve për raportet përfundimtare.

2.3.6 Operatori ekonomik të paraqesë deklaratë që Stafi i deklaruar për përmbushjen e shërbimeve të jetë i disponueshëm gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Deklarata dëshmon që personat e përfshirë janë vërtet të gatshëm dhe në dispozicion për të punuar në projekt gjatë periudhës së përcaktuar si dhe shërben për të dëshmuar menaxhim të mirë të burimeve njerëzore dhe planifikim të mirëfillt të punës.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të paraqesë të paktën 1 (një) licencë software për përpunimin e fotove ajrore, ku të jenë të përfshira funksionalitetet për zbatimin e objektit të prokurimit, të vlefshme deri në fund të periudhës së shërbimit, si dhe një person të trajnuar për përdorimin e këtij software. Zotërimi i licencës së software të jetë i vërtetuar me dokumentat përkatëse nga prodhuesi i software ose distributori i autorizuar.

Për personin e trajnuar sipas pikës 2.3.7 të paraqitet dokumentacioni provues për trajnimin e lëshuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar.

Kërkesa për një person të trajnuar për përdorimin e software konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Deklarata provuese e kërkuar më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të mjetet e nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit.

Kërkesa lidhet drejtpërdrejt me sigurinë, cilësinë dhe vazhdimësinë e realizimit të objektit të prokurimit. Licenca e softuerit garanton që operatori ka në dispozicion mjetet teknologjike të avancuara dhe të licencuara ligjërisht për kryerjen e këtyre funksioneve në cilësinë dhe saktësinë e kërkuar nga projekti., konkretisht realizohen korrigjime gjeometrike, montim të imazheve, analiza fotogrametrike dhe hartografike..etj. Kërkohet që të vërtetohet me dokumenta provuese nga prodhuesi i software ose distributori i autorizuar për tu siguruar që licenca është e vlefshme dhe e ligjshme, krijon besueshmerine se operatori ka marrë trajnim zyrtar ose suport teknik nga burime të besueshme. Kërkohet një person i trajnuar pasi një softuer i avancuar për përpunimin e ortofotove kërkon njohuri të specializuara që të përdoret saktë, duke garantuar rezultatet e kërkuara.

2.3.8 Operatorët ekonomikë duhet të deklarojnë se do të realizojnë shërbimin sipas kërkesave dhe specifikimeve të kërkuara përkatësisht nga Autoriteti Kontraktor ASIG.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mesiperme është një besueshmeri dhe garanci në përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në DST.

Operatorët ekonomikë garantojnë se do të respektojnë plotësisht të gjitha specifikimet teknike, standardet dhe kushtet që përcakton ASIG, duke siguruar cilësi dhe përputhshmëri me objektivat e shërbimit të kërkuar.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, termat e referencës dhe përlllogaritja e fondit limit janë përgatitur dhe hartuar nga Autoriteti Kontraktor “Autoriteti Shtetëror Për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG)”, për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i

Blerjeve të Përqendruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

NJËSIA E PROKURIMIT